



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 28. 01. 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Enis Kervan, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu, Ardian Gjini, Ramë Buja dhe Dragisa Miric.

Munguan: Xhavit Haliti, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi dhe Nexhat Daci.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit, me këtë

R E N D I T E

- 1. Miratimi i Raportit për punën e Komisionit gjatë vitit 2008,**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës,**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i Raportit për punën e Komisionit gjatë vitit 2008

Sabri Hamiti - Për punën njëvjeçare të Komisionit tha se është përgatitur një raport pune, në të cilin në pika themelore është paraqitur esenca e aktiviteteve të Komisionit.

Komisioni e shqyrtoi Raportin e punës dhe e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Raporti i punës i Komisionit për vitin 2008.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës

Sabri Hamiti - Për Projektligjin e protokollit të shtetit të Republikës së Kosovës, tha se Komisioni do të ngarkohet, në cilësi të komisionit funksional, për shqyrtimin e tij.

Projektligji është radhitur për shqyrtim në parim në Komision, me qëllim të përcaktimit tonë si Komision se a e përkrahim të miratohet apo jo në seancën plenare.

Në vazhdim shtoi se Projektligji për protokollin është më se i domosdoshëm dhe se e përkrah miratimin e tij në parim.

Mangësitë evidente në këtë projektligj do të angazhohemi t'i evitojmë me amendamente gjatë shqyrtimit të tij në Komision.

Ramadan Avdiu – E përkrah miratimin në parim të Projektligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, si projektligj shumë të nevojshëm.

Mendon se Projektligji ka mangësi teknike dhe përmbajtjesore, që duhet të amendamentohen.

Ardian Gjini – Lidhur me përmbajtjen e Projektligjit tha se nuk i rregullon të gjitha çështjet protokollare, prandaj edhe shpreh dyshim se mund të plotësohet tërësisht me anë të amendamenteve.

Po ashtu tha se shumë çështje në Projektligj i lihen në kompetencë Ministrisë që t'i rregullojë me akte nënligjore, megjithëse mund të rregulloheshin me anë të Projektligjit. Shtoi se e vlen të përmendet mendimi i Divizionit të Kuvendit, se Qeveria me rastin e hartimit të këtij projektligji nuk i është përmbajtur Udhëzimit administrativ për hartimin e projektligjeve.

Arsim Rexhepi - Mendon se propozuesi me rastin e hartimit të Projektligjit nuk e ka konsultuar fare MPJ-në. Projektligji, me gjithë mangësitë e mëdha që i ka, për themelimin e strukturave të Zyrës së Protokollit, për mungesë sanksionesh, tha se është i nevojshëm dhe duhet të miratohet në parim.

Eqrem Kryeziu - Vërejtjet lidhur me Projektligjin i gjen në trajtimin e autoriteteve, për të cilat mendon se duhet të kenë trajtim të njëjtë të autoriteteve të barabarta. Vërejtje tjetër ka për përmbajtjen e tepërt të materies, për të cilën mendon se nuk është e nevojshme të përfshihet në ligj. E përkrah miratimin në parim të Projektligjit.

Ramë Buja - E përkrah miratimin në parim të Projektligjit, kurse për mangësitë e shumta të tij tha do të bëjmë përpjekje që të amendamentohen.

Komisioni pas diskutimeve e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Përkrahet miratimi në parim i Projektligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:35.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti